



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 04 tetor 2019
Nr. Ref.:RK 1438/19

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI36/19

Parashtrues

Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të
Kosovës, E. Rev. nr. 26/2017, të 17 janarit 2018**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale (në tekstin e mëtejme: parashtruesja e kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesja e kërkesës konteston kushtetutshmërinë e Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, E. Rev. nr. 26/2017, të 17 janarit 2018 (në tekstin e mëtejme: Aktgjykimi i kontestuar), për të cilin pohon se e ka pranuar më 12 shkurt 2018.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar, me të cilin parashtruesja e kërkesës pretendon shkeljen e të drejtave të saj të garantuara me nenet: 3 dhe 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara], në lidhje me paragrafin 4, të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesat Individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 1 mars 2019, parashtruesja e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 5 mars 2019, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Bajram Ljatifi, gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Bekim Sejdiu (kryesues), Selvete Gërxhaliu-Krasniqi dhe Gresa Caka-Nimani (anëtare).
7. Më 15 mars 2019, Gjykata njoftoi parashtruesen për regjistrimin e kërkesës KI36/19 dhe një kopje të saj ia dërgoi Gjykatës Supreme, në pajtim me ligjin.
8. Më 11 shtator 2019, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Në një datë të pasaktësuar, kompania "Besi Com" sh.p.k (në tekstin e mëtejme: Paditësja) ushtroi padi, në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike, kundër parashtrueses së kërkesës, për kompensim dëmi në shumën monetare prej 43.775,00 Euro.
10. Më 28 mars 2017, Gjykata Themelore në Prishtinë, me Aktgjykimin IC. nr. 207/2015, aprovoi padinë e paditëses dhe e detyroi parashtruesen e kërkesës

që paditëses t'ia paguaj shumën e përgjithshme prej 66.316.39 Euro, në emër të dëmit material, duke e përfshirë edhe kamatën ligjore dhe shpenzimet e procedurës kontestimore.

11. Në një datë të pasaktësuar, parashtruesja e kërkesës parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.
12. Më 25 tetor 2016, Gjykata e Apelit me Aktgjykimin Ae. nr. 128/2017, refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtrueses së kërkesës dhe e vërtetoi Aktgjykimin IC. nr. 207/2015 e gjykatës së shkallës së parë, të 28 marsit 2017.
13. Parashtruesja e kërkesës, në afat ligjor, ushtroi kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të dy aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët të ndryshohen dhe padia e paditëses të refuzohet si e pabazuar.
14. Më 17 janar 2018, Gjykata Supreme, me Aktgjykimin e kontestuar E. Rev. nr. 26/2017, refuzoi si të pabazuar kërkesën për revizion të ushtruar nga parashtruesja e kërkesës kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit dhe aprovoi pjesërisht kërkesën e parashtrueses sa i përket pikës I) nën shkronjën a) të dispozitivit, përkitazi me kamatën ligjore.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

15. Parashtruesja e kërkesës pretendon se me Aktgjykimin e kontestuar i janë shkelur të drejtat e garantuara me nenet 3 dhe 24 të Kushtetutës: *“Si pasojë e shkeljes procedurale të nenit 19 të Ligjit nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore, ku secila gjykatë gjatë gjithë procedurës së shkallës së parë, sipas detyrës zyrtare kujdeset për kompetencën e vet lëndore, në raport me parashtruesat e bëra dhe ankesat ...”*.
16. Përveç kësaj, parashtruesja e kërkesës pretendon dhe në shkelje të neneve 31 dhe 54 të Kushtetutës, sepse: *“Në rastin konkret Gjykatat e Republikës së Kosovës në mënyrë të vazhdueshme kanë bërë shkelje procedurale dhe shkelje të dispozitave materiale”*.
17. Në fund, parashtruesja e kërkesës nga Gjykata kërkon të: *“Anulohet si i pabazë Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës-Departamenti për çështje Ekonomike, E. Rev. nr. 26/2017, dt.17.01.2018, protok.nr.1079, dt.12.02.2018, Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit-Departamenti për çështje Ekonomike, Ae. nr. 128/2017 dt.25.10.2017, Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për çështje Ekonomike, IC. nr. 207/2015 dt.28.03.2017, pasi që nuk janë në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës duke vendosur që kjo çështje të kthehet në rishqyrtim për rivendosje dhe të vendoset sipas detyrës zyrtare të dërgohet në kompetencë lëndore që kjo lëndë e kontestuar të shqyrtohet në Departamentin për çështje Administrative dhe më pastaj të*

shqyrtohet se paditësi ka pasur bazë ligjore për kërkesë për kompensim dëmi”.

Pranueshmëria e kërkesës

18. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe të përcaktuara me Rregullore të punës.
19. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara], në lidhje me paragrafin 4. të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.

[...]

4. Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejné edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme.”

20. Gjykata gjithashtu vlerëson nëse parashtuesja e kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç specifikohet më tej në Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata së pari u referohet neneve 47 [Kërkesa individuale] dhe 48 [Saktësimi i kërkesës] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47 i Ligjit [Kërkesa individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individ i mund të ngre kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

Neni 48 i Ligjit [Saktësimi i kërkesës]

“Parashtuesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtuesi dëshiron ta kontestoj”.

21. Sa i përket përmbushjes së këtyre kriterëve, Gjykata konstaton se parashtuesja e kërkesës është palë e autorizuar; i ka shterur mjetet juridike të parapara me ligj, e ka saktësuar aktin e kontestuar të autoritetit publik dhe gjithashtu i ka

sqaruar të drejtat dhe liritë që pretendon se i janë shkelur me aktet e autoriteteve publike.

22. Megjithatë, Gjykata gjithashtu shqyrton nëse janë përmbushur kriteret e përcaktuara me nenin 49 [Afatet] të Ligjit dhe rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë], respektivisht paragrafin (1) (c) të Rregullores së punës, dispozita të cilat përcaktojnë si në vijim:

Neni 49 i Ligjit
[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”

Rregulli 39 i Rregullores së punës
[Kriteret e Pranueshmërisë]

“(1) Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të pranueshme nëse:

[...]

c) kërkesa parashtrohet brenda katër (4) muajsh nga dita kur vendimi i mjetit të fundit efektiv juridik i është dorëzuar parashtruesit, dhe [...].”

23. Gjykata vë në dukje se parashtruesja e kërkesës e konteston Aktgjykimin E. Rev. nr. 26/2017 të Gjykatës Supreme, të 17 janarit 2018, të cilin deklaroi se e ka pranuar më 12 shkurt 2018, ndërsa kërkesën në Gjykatë e ka dorëzuar më 1 mars 2019, që nënkupton se kërkesa është dorëzuar pas afatit ligjor prej 4 (katër) muajsh.
24. Gjykata rikujton se qëllimi i afatit ligjor prej 4 (katër) muajsh, sipas nenit 49 të Ligjit dhe sipas rregullit 39 (1) (c) të Rregullores së punës, është që të promovojë siguri juridike, duke siguruar që rastet që kanë të bëjnë me çështje kushtetuese të trajtohen brenda një periudhe të arsyeshme dhe të parandalohet mbajtja në gjendje pasigurie për një periudhë të gjatë kohore e palëve dhe personave të tjerë të përfshirë (shih, *mutatis mutandis* rastin *Sabri Güneş kundër Turqisë*, kërkesa nr. 27396/06, Aktgjykim i GJEDNJ-së, i 29 qershorit 2012, paragrafi 39; dhe, rastin e Gjykatës Kushtetuese nr. KI140/13, *Ramadan Cakiqi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 17 marsit 2014, paragrafi 24).
25. Nga kjo rrjedh se, kërkesa e parashtrueses së kërkesës është dorëzuar jashtë afatit të përcaktuar me nenin 49 të Ligjit dhe me rregullin 39 (1) (c) të Rregullores së punës, dhe si e tillë është e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenin 49 të Ligjit dhe në pajtim me rregullin 39 (1) (c) të Rregullores së punës, më 11 shtator 2019, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Bajram Ljatifi



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi